



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/OPSTINA STIMLJE/MUNICIPALITY SHTIME

Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Mayor's office

Data/Datum/Date:	17.01.2023
Nr/Br/No:	Zrt. 02/16
Për/Za/To:	Anëtarët e Kuvendit Komunal të Shtimes
Nga/Od/From:	Zyrës së Kryetarit, z. Qemajl Aliu
Lënda/Predmet/ject:	Informatë për punën e KKSb-së për vitin 2022

Duke u bazuar në nenin 9 Detyrat dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të KKSb-së të UA nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, pika 1.7 dhe 1.8 Kryetari i Komunës paraqet Informatë për punën e KKSb-së për vitin 2022.

Informatë për punën e KKSB-së për vitin 2022

Duke qenë se themelimi dhe përbërja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) është kategori kushtetuese, e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, edhe kemi themeluar këtë mekanizëm në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

KKSB është kryesuar nga Kryetari i Komunës. Në rastet e mungesës së kryetarit, KKSB është kryesuar nga Nënkryetari i komunës.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 6 takime në vitin 2022. Mbledhja e parë është mbajtur me 20 maj 2022, e dyta më 28 qershor, e treta më 3 gusht, e katërta më 14 tetor, e pesta më 30 nëntor dhe e fundit më 19 dhjetor 2022.

Ashtu siç janë të parapara me Udhëzimin Administrativ, KKSB është angazhuar në 5 objektiva kryesore:

1. “Rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal;
2. Identifikimin e problemeve dhe brengave lidhur me sigurinë publike;
3. Rekomandimin e planeve të veprimit dhe adresimin e brengave të qytetarëve te autoritetet komunale;
4. Ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi;
5. Përfaqësimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve për çështjet e krimit dhe çështjet e tjera që lidhen me kualitetin e jetës.

Identifikimi i problemeve rreth sigurisë në bashkësi është veçuar si njëra ndër detyrat kryesore të anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Kjo për arsye se zgjidhja e problemeve rreth sigurisë publike është çështje e cila u takon të gjithë pjesëmarrësve dhe institucioneve shtetërore.

KKSB vazhdimisht është angazhuar që të sigurojë metoda dhe mjete të përshtatshme për krijimin e kontakteve të rregullta me qytetarë.

Bashkëpunimi me Policinë

KKSB ka arritur që të ndërtojë besimin reciprok në mes qytetarëve dhe policisë. Përmes KKSBS së qytetarët e kanë më të lehtë që problemet e tyre t'i adresojnë në mënyrë më të organizuar. Prandaj, roli i Policisë së Kosovës në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit, është që të paraqesë në Këshill shqetësimet kryesore të komunitetit lidhur me sigurinë në bashkësi. Gjithashtu pjesëmarrja në mbledhje, e Komandantit të Stacionit Policor, në Shtime, në cilësinë e anëtarit të KKSBS-së, përveç raportimit, ka qenë një ndërlidhje për transmetim të përfundimeve të KKSBS-së.

Ky bashkëpunim ka ndikuar në ndërtimin e besimit të qytetarëve tek organet e rendit, forcimin e ndjenjës së sigurisë në mjedisin ku jetojnë, u ka mundësuar banorëve ambient të sigurt, siguri në zbatimin e ligjit dhe ka bërë që qytetarët t'i paraqesin problemet tek policia. Po ashtu, komunikimi dhe bashkëpunimi në mes kryetarit të komunës, drejtorive përkatëse, inspektionit të komunës dhe Komandantit të Stacionit të Policisë dhe zyrtarëve të tjerë ka qenë i vazhdueshëm.

KKSB është duke punuar në hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për periudhën 3 vjeçare ku është paraparë që të kërkohet nga Kuvendi i Komunës dhe donatorët financimi i projekteve të lidhura me sigurinë në bashkësi. Projekte të këtilla janë identifikuar dhe kanë të bëjnë me ndriçimin publik, menaxhimin e mbeturinave, çështjet e inspektimit, ndërtimet pa leje, standardet e ndërtimit, mungesën e infrastrukturës në shkolla, mungesën e transportit publik në vendbanime të ndryshme, problemin e qeneve endacakë, mungesën e ofrimit të shërbimit primar shëndetësor, mungesën e semaforëve, "policëve të shtrirë", mungesën e kanalizimit në disa lagje, nevojën për parqe publike, kontrollin e ushqimit, shëndetin publik etj. Të gjitha këto do të analizohen sipas Planit të Veprimit, në vazhdimësi, dhe nëse konstatohet që komuna nuk i ka përfshirë këto çështje në planet strategjike atëherë këto projekte që reflektojnë segmente të sigurisë në bashkësi, do të inicohen nga KKSBB në Kuvendin e Komunës, dhe do të kërkohet përfshirja e tyre në projeksionet buxhetore afatshkurtra dhe afatgjata. Kjo do të jetë më lehtë e realizueshme pasi që KKSBB, gjatë hartimit të projekt-buxhetit të komunës për vitin pasues, do të marrë pjesë në diskutimet buxhetore dhe do të parashtojë propozimet konkrete për projektet e sigurisë në bashkësi.

Nga takimet e KKSBS-së, 6 sa janë mbajtur gjatë vitit 2022, është arritur:

- Shkëmbimi i informatave rreth problemeve të sigurisë;
- Konsultimi për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi;
- Takime të rregullta mes zyrtarëve të komunës dhe zyrtarëve policor;

- Pjesëmarrja e rregullt e zyrtarëve policorë në takimet e KKSB-së;
- Bashkëpunimi me Këshillin Lokal për Siguri Publike;
- Bashkëpunimi me Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi;
- Prezenca e rregullt e policisë në zbatimin e masave të caktuara administrative nga organet komunale;
- Informimi për çështjet e sigurisë në bashkësi .

Disa nga Rekomandimet, nga takimet e KKSB-së:

- Kontrolli më efektiv në bashkësi (nga të gjithë akterët e sigurisë);
- Apel përmes fletëpalosjeve për mbrojtjen e ambientit;
- Shtimi i aktiviteteve në shkolla për vetëdijësim ndaj dukurive negative;
- Rritje e efikasitetit të policisë;
- Rritje e besimit në Policinë e Kosovës;
- Më shumë aktivitete për rininë;
- Forcimi i komunikimi me policinë;
- Siguria e shtuar për fëmijët dhe të moshuarit (intervenimi në infrastrukturë sipas projekteve të identifikuar).

Mesazhi nga çdo mbledhje e KKSB-së ka qenë inkurajimi i qytetarëve për të raportuar dhe dëshmuar për të gjitha veprimet negative që ndikojnë në sigurinë e përgjithshme.

KKSB do të punojë në përputhje me nevojat e komunitetit për siguri.

KKSB, qëllim më vete do të ketë punën efikase dhe efektive për të parandaluar rreziqet për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve të Komunës së Shtimes, duke kërkuar forcimin e kompetencave të anëtarëve të Këshillit dhe anëtarëve të grupeve të punës dhe duke përmirësuar vazhdimisht mënyrën e funksionimit dhe komunikimit brenda Këshillit dhe me palët përkatëse të interesit.